

Rrjeta interaktive për arsim dhe resurse

Rini e mbrojtur dhe e sigurt. Net

**Pronësi intelektuale dhe
Licencë për qasje të lirë**

Pronësi intelektuale


Pronësia intelektuale është term për marrëdhëniet juridike që ju ndahen tipave të ndryshëm të informatave, ideve ose dokumenteve në formën e tyre të shprehur. Termi pronësi intelektuale d.m.th. se bëhet fjalë për diçka që është produkt i intelektit apo mendjes, dhe është e mbrojtur me ligj ashtu si çdo formë tjetër e pronës. Por, duhet që të kemi kujdes që të mos teprohet me mbrojtjen dhe të shkohet në skajshmëri, që disa e quajnë proteksionizëm intelektual.

Debatet e sotshme, pronësia e të drejtave autoriale ndaj disa materialeve më së shpeshti shqyrtohen nga aspekti i përfitimit ekonomik se sa i të drejtës, dhe më pak si nevojë e palëve konkrete për t'i shfrytëzuar të mirat materiale në forma dhe nevoja të ndryshme.

Në nivelin e sotshëm të zhvillimit të teknologjisë çdo njeri i planetit i cili shfrytëzon ndonjë farë teknologjie ka kopje të së paku një dokumenti të bërë në formë jolegale. Të gjithë kemi bërë së paku regjistrimin e muzikës në CD në një CD tjetër apo në kompjuter, të gjithë kemi riinçizuar video film në video kasetë, CD apo DVD, të gjithë kemi kopjuar libra ose pjesë të ndonjë libri. Ndërsa të gjithë e dimë se sipas ligjit për mbrojtjen e të drejtave autoriale, ky veprim është i ndaluar. D.m.th., të gjithë veprojmë në mënyrë kriminale. Eventualisht, nëse ekziston njeri i cili nuk shfrytëzon CD regjistruar, video regjistruar, kompjuter apo teknologji tjetër, vetëm ai nuk bën një shkelje të tillë të ligjit.

Por, sido që të jetë, këto teknologji na japin mundësi për një shfrytëzim të tyre krejtësisht të ndryshëm dhe shfrytëzimin e informata dhe dokumenteve që janë të arritshme. Më herët mendonim për pronësinë si shfrytëzimi i të mirës së dikujt dhe me këtë shfrytëzim zvogëlonim mundësinë e shfrytëzimit të asaj të mire nga të tjerët. Për shembull, nëse marrim mollën e dikujt dhe e kafshojmë, do të ngelet më pak për të ngrënë për pronarin ose për të tjetër. Kjo nuk ndodh gjatë shfrytëzimit të teknologjisë. Nëse në kompjuter hapim ndonjë dokument (dhe me këtë në të shumtën e rasteve e kopjojmë në kompjuterin tonë) ne me asgjë nuk e zvogëlojmë atë dokument ose informatën e arritshme për pronarin dhe shfrytëzuesit e tjerë. Përkundrazi, dokumentin ose informatën mund ta plotësojmë për shfrytëzuesin e ardhshëm.

Në këtë mënyrë, gjatë shfrytëzimit të teknologjive të reja, krijohet një logjike e re e të logjikuari dhe raporti ndaj pronësisë. Një numër i vogël i autorëve që i vendosin veprat e tyre, qoftë të karakterit artistik ose akademik, në Internet mundohen që në çdo mënyrë t'i mbrojnë ato. Trend në përmasa botërore është Licenca për qasje të lirë, me çfarë ju mundësohen disa të drejta të caktuara për mënyrën e shfrytëzimit shfrytëzuesve të dokumenteve, muzikës ose punimeve akademike.



Licenca për qasje të lirë (Creative Commons)

Interneti iu siguron hulumtuesve shpalljen e rezultateve nga hulumtimet e tyre që të jenë të arritshme për secilin dhe në çdo kohë, autorëve që të prezantojnë punimet e tyre përpara një auditori të gjerë ndërkombëtar. Njëkohësisht autorët mund t'ju japin leje të gjithë shfrytëzuesve të ardhshëm se në ç'mënyrë mund ta shfrytëzojnë veprën, hulumtimin apo punimin akademik të tyre. Leja mund të përfshijë shfrytëzim të plotë, shfrytëzimi për qëllime jo komerciale ose shfrytëzimi i kufizuar sipas zgjedhjes sonë. (<http://creativecommons.org/about/licenses>). Por, në cilin do qoftë rast shfrytëzuesit janë të obliguar të përmendin emrin e autorit origjinal të veprës.

Me këto licenca hapen mundësi dhe perspektiva krejtësisht të reja të cilat janë shumë larg na përditshmëria jonë dhe do të nevojitet mund i stërmadh për t'u përshtatur dhe për t'i pranuar.



Disa punë tani më funksionojnë sipas kësaj mënyre edhe në përditshmërinë tonë, edhe pse nuk jemi plotësisht të vetëdijshëm për këtë. Në ditët e sotme, kudo që të jetë është e vështirë të gjendet një punim i cili nuk ka shfrytëzuar së paku një citat nga Wikipedia.¹ Të drejtat autoriale të shkrimtarëve dhe shfrytëzuesve të Wikipedias janë të përcaktuara me licencë specifike të hapur. Licencën që e përdor Wikipedia siguron qasje të lirë deri te përmbajtja në të njëjtën mënyrë siç e siguron

edhe licenca e lirë për softuer të lirë. Ky princip quhet kopyleft, në kundërshtim me kopirajt. Kjo do të thotë se përmbajtjet e Wikipedias mund të kopjohen, modifikohen, ridistribuheshin derisa versioni i ri jua siguron të njëjtat të drejta shfrytëzuesve të ardhshëm dhe ua bën të ditur autorëve të Wikipedias artikullin që është shfrytëzuar (lidhja e drejtpërdrejtë deri te artikulli e plotëson të drejtën e një autori). Të gjithë artikujt në Wikipedia do të jenë të lirë për gjithmonë dhe do të mund të shfrytëzohen nga çdokush, me kufizime të caktuara, kryesisht të domosdoshme për mbrojtjen e lirisë së shfrytëzimit. (www.mk.wikipedia.org).

Wikipedia funksionon dhe është shumë e suksesshme meqë rreth vetes grumbullon një shoqëri të wiki-editorëve. Çdonjëri që ka dëshirë, mendon që ka diçka që të shtojë ose të diskutojë, mund të fusë temën e tij ose të komentojë informacionet e vendosura. Nëse një numër i madh i lexuesve të Wikipedias reagojnë rreth pasaktësisë së një artikulli, ajo vendoset për t'u fshirë dhe varësisht nga reagimi i shfrytëzuesve të ardhshëm do të fshihet tërësisht ose do të kthehet si tekst në të njëjtën faqe. Ky është një proces tërësisht demokratik i zgjedhjes së informatave të



¹ Wikipedia është enciklopedi online me përmbajtje të lirë e hapur për t'u lexuar dhe ndryshuar. Ajo ka botime në 187 gjuhë të ndryshme e sponsoruar nga ana e Fondacionit Wikimedia jofitimprurës. Informata lidhur me tema enciklopedike tradicionale të cilat qëndrojnë pranë temave të almanakëve, gazetave dhe ngjarjeve aktuale. Qëllimi i Wikipedias është që të krijojë "botë në të cilën çdo individ ka qasje të lirë deri te tërësia e njohurive të përgjithshme njerëzore". Wikipedia është njëri ndër vendet më popullore referuese në Internet, duke pranuar rreth 50 milionë shfrytëzues në ditë. Çdo shfrytëzues mund të shtojë dhe ndryshojë artikuj. Projekti i Wikipedias filloi në janar të 2001, ndërsa projekti në gjuhën maqedonase ekziston që nga shtatori 2003. (www.mk.wikipedia.org).

sakta dhe relevante dhe të gjithë ata që për çdo ditë e konsultojmë Wikipedian në punën tonë jemi dëshmitarë se funksion jashtëzakonisht mirë.

Mundësi tjetër e qasjes së lirë janë bllogjet. Bllog² është web-faqe në të cilën publikohen shitesa (shkrime) të caktuara kohore me një ritëm të rregullt dhe pasqyrohen me një rend kronologjik të mbrapsht (më i riu më lart). Bllogu mund të përbëhet nga tekst, hipertekst, fotografi, linqe, si edhe mundësia për dhënien e komenteve. Shpeshherë një bllok i dhënë ka një temë ose fushë të veçantë të cilën e mbulon, ndërsa disa ju dedikohen diskutimeve të përvojave personale. Bllogjet si media arritën popullaritet dhe rëndësi në fillim të shekullit XXI, duke promovuar konceptin e gazetarisë qytetare.

Në Maqedoni më 25 janar 2006 u soll Ligji për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik. Me këtë ligj sigurohet bërja publike dhe hapja e punës së zotëruesve të informacioneve, ju mundësohet personave fizik dhe juridik që të realizojnë të drejtën e qasjes së lirë deri te informatat me karakter publik.

Pyetjet e mundshme për diskutim:

- **A duhet të vendosen veprat (muzikore, letrare, filmike) online papagesë?**
Si do të përfitonin autorët në këto raste?
- **A duhet të kopjojmë softuer ose muzikë edhe nëse dimë që jo ligjërisht janë përvetësuar?**
- **Si të bëhen bllogjet më interesant dhe më tërheqës për një numër të madh të shfrytëzuesve? Ç'farë dobie do të kemi nga kjo?**

² Termi bllok është shkurtesë e web-llog (weblog, web log), term i cili në përkthim do të thotë "ditar i web faqes". Shkrimi ose mirëmbajtja e bllokut, apo shtimi i shkrimit quhet "bllogim". Shkrimet e veçanta të bllogut quhen "postime", ndërsa personi i cili i vendos quhet "blloger".